



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DREJTORIA E ARSIMIT

**PLANI I VEPRIMIT PËR PARANDALIMIN E BRAKTISJES
DHE MOSREGJISTRIMIT TË SHKOLLËS
2024 - 2026**

Mitrovicë, dhjetor 2023

Përmbajtja

Përmbajtja	2
Shkurtesat.....	3
HYRJE	4
Konteksti	6
Numri i nxënësve sipas strukturës etnike në vitin shkollor 2023/24.....	8
Numri i nxënësve me nevoja të veçanta në vitin shkollor 2023/24	8
Largësia e udhëtimit të nxënësve në vitin shkollor 2023/24.....	9
Gjendja familjare e nxënësve në vitin shkollor 2023/24.....	10
Gjendja sociale e nxënësve në vitin shkollor 2023/24	10
Raporti i mungesave për kokë nxënësi sipas niveleve shkollore	10
Braktisja e shkollës në tri vitet e fundit.....	11
Qëllimi i planit të punës	12
Objektivat e Planit Komunal të Veprimit	12
Rezultatet kryesore të pretenduara:	13
Shtojca	23

Shkurtesat

=====

MAShTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
DA	Drejtoria e Arsimit
SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim
ShFMU	Shkollë Fillore e Mesme e Ulët
ShML	Shkollë e Mesme e Lartë
IP	Institucion Parashkollor
EPRBM	Ekipi për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit
KN	Këshilli i nxënësve
KP	Këshilli i prindërve
KPAK	Komiteti i Prindërve të Arsimit të Kosovës
QPS	Qendra për Punë Sociale
OJQ	Organizatë Joqeveritare
UNICEF	Fondi Ndërkombëtar për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara
ECMI	Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve
PN	Paralele e Ndarë

HYRJE

Duke u mbështetur në një varg konventash dhe standardesh ndërkombëtare, të cilat kërkojnë qasje dhe mundësi të barabartë në arsim cilësor, shteti ka detyrim të ndërmarr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar të drejtën e arsimit për të gjithë qytetarët e vet pa dallim gjinie, etnie, aftësie e gjendje tjetër.

Pasi që po flasim për shkollat dhe nxënësit e arsimit parauniversitar, po i referohemi ekskluzivisht **Konventës për të Drejtat e Fëmijës**, si traktati që i mbulon në mënyrë gjithëpërfshirëse të drejtat e fëmijës në çdo cep të botës. Duke u thirrur në parimet bazë të kësaj konvente, shtetet orientojnë politikat nacionale, prandaj ato janë bazamenti i të drejtave universale për çdo fëmijë/individ: **Mosdiskriminimi, Pjesëmarrja, Interesi më i lartë i fëmijës dhe Zhvillimi i potencialit të plotë.**

Bazuar në këto parime, institucionet arsimore duhet të kujdesen për pjesëmarrje dhe gjithëpërfshirje në arsim cilësor, duke siguruar zhvillimin e fëmijëve brenda potencialit të plotë.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës (Nenin 47) dhe legjislacioni i arsimit garantojnë të drejtën e arsimimit për të gjithë pa dallim gjinie, etnie, aftësie a gjendje tjetër, duke pasur për bazë të drejtat e njeriut/fëmijës.

Ligjet aktuale: Ligji për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, Ligji për Arsimin Parauniversitar, Ligji për Arsim dhe Aftësim Profesional, Ligji për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur, Ligji për Ligji për Inspektoratin e Arsimit në Kosovë, Ligji për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, etj., ku bashkë me aktet nënligjore përcjellëse adresojnë mundësitë e barabarta dhe qasjen e gjithëpërfshirëse në arsim cilësor.

Barrierat e natyrave të ndryshme brenda sistemit arsimor, sidomos ato të qasjes në arsim, ndërlidhur me faktorët e shumtë individualë, familjarë e shoqërorë me kontekste të ndryshme sociale, ekonomike, shëndetësore e kulturore, kërkojnë qasje multidisiplinare, prandaj i kemi ligjet tjera relevante, si: Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale, Ligji i Policisë, Shëndetësisë, e ligje të tjera, që bashkë me rregulloret dhe mekanizmat

tjerë institucionale, kërkojnë bashkëveprimin e plotë për të funksionuar si hallka të shtetit në adresimin e problemeve me të cilat ballafaqohemi.

Legjislacioni i arsimit, obligon institucionet përgjegjëse si: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, komunat, institucionet arsimore dhe komunitetin, që të marrin të gjithë hapat e arsyeshëm, që institucionet arsimore të jenë cilësore, gjithëpërfshirëse, humane dhe të sigurt, siç e kërkojnë politikat arsimore, përfshirë standardet për shkollat mike, kurrikulat dhe secila hallkë e sistemit arsimor. Janë një varg aktesh nënligjore që ndihmojnë zhvillimin e procedurave për sigurimin e qasjes e barabartë në arsim dhe zbatimin e ligjeve në fuqi.

Pastaj ekzistojnë dokumentet strategjike relevante që për prioritet kanë pjesëmarrjen dhe gjithëpërfshirjen në arsim, si dhe dokumentet tjera strategjike ndër-sektorale dhe procedurat standarde që adresojnë aspektet e qasjes në arsim të viktimave të trafikimit, dhunës, krimit dhe rrethanave tjera çfarëdo qofshin ato.


Në funksion të zbatimit të këtyre politikave dhe konkretisht në adresimin e pjesëmarrjes në arsim, ne me këtë plan komunal përqendrojmë vëmendjen te parandalimi dhe reagimi ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të nxënësve në shkollë, për të siguruar që të gjithë fëmijët, të jenë përfitues të sistemit arsimor dhe të zhvillohen brenda potencialit të plotë.

Konteksti

Vitin e ri shkollor 2023/24 e kanë filluar 14,023 nxënës, që i vijojnë mësimet në 38 institucionet arsimore të mëposhtme:

- 1 Institucion Parashkollor (IP);
- 26 Shkolla Fillore të Mesme të Ulëta (ShFMU);
- 6 Paralele të Ndara të Shkollave Fillore të Mesme të Ulëta (PN të ShFMU);
- 5 Shkolla të Mesme të Larta (ShML);

Sipas të dhënave zyrtare të regjistruara në SMIA, numri i nxënësve në institucionet parashkollore është 378 fëmijë (280 në çerdhe dhe 98 në shkolla për grup-moshat 3-5 vjeç); në nivelin parafillor/klasa përgatitore 804 nxënës, në nivelin fillor 5283 nxënës, në nivelin e mesëm të ulët 4265 nxënës dhe në nivelin e mesëm të lartë 3293 nxënës. Nga numri i përgjithshëm i nxënësve që janë përfshirë në të gjitha nivelet shkollore, numri më i madh i nxënësve është në arsimin fillor (38% e numrit të përgjithshëm), ndërsa numri më i vogël i fëmijëve është në arsimin parashkollor (3% e numrit të përgjithshëm).



Të dhënat e tjera, sipas klasave për nivele shkollë, mund t'i shihni në tabelarin e mëposhtëm:

Klasa/Niveli	Mashkull	Femër	Gjithsej
Grupa 1-2	20	20	43
Grupa 2-3	35	28	63
Grupa 3-4	54	39	93
Grupa 4-5	53	46	99
Grupa 5-6 – Parashkollor (Çerdhe)	39	41	80
Gjithsej Parashkollor (0-5 vjeç)	201	174	378
Gjithsej Parafillor (Klasa përgatitore)	415	389	804
Klasa 1	536	532	1068
Klasa 2	518	467	985
Klasa 3	523	520	1043
Klasa 4	587	521	1108
Klasa 5	561	518	1079
Gjithsej Arsimit Fillor (Klasa 1-5)	2725	2558	5283
Klasa 6	494	553	1047
Klasa 7	565	551	1116
Klasa 8	541	497	1038
Klasa 9	548	516	1064
Gjithsej Arsimit Mesëm i Ulët (Klasa 6-9)	2148	2117	4265
Klasa 10	548	599	1147
Klasa 11	485	604	1089
Klasa 12	491	566	1057
Gjithsej Arsimit Mesëm i Lartë (Klasa 10-12)	1524	1769	3293
Gjithsej nxënës në të gjitha nivelet shkollë	7013	7007	14023

Numri i nxënësve sipas strukturës etnike në vitin shkollor 2023/24

Mësimi në komunën tonë organizohet edhe në gjuhën boshnjake (ShFMU “Bedri Gjinaj”; Gjumnazi “Frang Bardhi”) dhe në gjuhën turke në ShFMU “A. Z. Çajupi”. Nxënësit e minoritetit Ashkalinj e vijnë në mësimin në gjuhën shqipe dhe janë të integruar në klasat e rregullta me nxënës shqiptar. Numri i nxënësve shumicë (shqiptar) është 13,932 ndërsa nxënës minoritar në nivel komune janë 91 nxënës.

Përkatësia etnike	Shqiptar	Turq	Boshnjak	Ashkali
Numri i nxënësve	13,932	17	19	55

Një shqetësim i cili na ka përcjellur vazhdimisht është edhe numri i fëmijëve të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas në lagjen “Adem Voca”, shqetësim të cilin e kemi ngritur në vazhdimësi deri edhe në MASHTI. Një numër i nxënësve të këtij lokaliteti, rreth 200 nxënës, i vijnë në mësimin në sistemin paralel, në komunën e Mitrovicës së Veriut. Këta nxënës udhëtojnë më shumë se 4 km, përkundër që Ligji për Arsimin Parauniversitar e parasheh që secili fëmijë duhet të regjistrohet në zonën e mbulimit të shkollës më të afërt. Këta nxënës janë plotësisht të segreguar në paralele të veçanta dhe mësojnë në gjuhën serbe. Gjatë diskutimeve me përfaqësuesit e këtij lokaliteti kemi arritur në përfundim se arsyeja qëndron për shkak të ndihmave sociale që i përfitojnë familjet. Në këtë lokalitet ekziston një qendër me bazë në komunitet, ku këtyre fëmijëve u mundësohet kryerja e detyrave të shtëpisë dhe aktivitetet e lira. Kjo qendër e shfrytëzon objektin e komunës, ish shkollën bujqësore pa asnjë kompensim si dhe çdo vit i ndihmojmë me sigurimin e një sasive të lëndës djegëse.

Numri i nxënësve me nevoja të veçanta në vitin shkollor 2023/24

Numri i nxënësve me nevoja të veçanta, që do ta ndjekin mësimin në këtë vit shkollor, në nivel komune është 174 nxënës, për të gjitha nivelet shkollore. Kuptohet, ky numër është i deklaruar nga shkollat në *Bazën e të dhënave zyrtare - SMIA* (Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim).

Lloji i dëmtimeve	Numri i nxënësve
Dëmtime intelektuale	24
Dëmtime në të dëgjuar	4
Dëmtime në të parë	21
Dëmtime fizike	18
Dëmtime të shumëfishta	15
Vështirësi në të folur, komunikim dhe të gjuhës	29
Autizëm	18
Çrregullime emocionale dhe të sjelljes	17
Vështirësi/Çrregullime në të nxënë	20
Deprivimet sociale, kulturore dhe gjuhësore	8
Sindromi Daun	24
Gjithsej	174

Largësia e udhëtimit të nxënësve në vitin shkollor 2023/24

Në tabelën e mëposhtme vërehet se numri më i madh i nxënësve (38.63%) distancën nga shtëpia e kanë më pak se 1 km, ndërsa distancën më shumë se 5 km e kanë 4.67% e nxënësve dhe këta janë nxënës të shkollave të mesme të larta, ku në shkollën e mjekësisë ka nxënës edhe nga komunat e tjera, pasi që është shkollë regjionale. Në arsimin e obliguar (Klasa 1-9) të gjithë nxënësve që e kanë distancën mbi 4 km, ne si komunë ua sigurojmë transportin.

Pasqyra e largësisë së udhëtimit të nxënësve												
< 1 km		1-2 km		2-3 km		3-4 km		4-5 km		> 5km		Gjithsej nxënës
Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
5417	38.63	4331	30.88	1995	14.23	1096	7.82	529	3.77	655	4.67	
												14023

Gjendja familjare e nxënësve në vitin shkollor 2023/24

Nga tabela e pasqyruar në vijim, e gjeneruar nga SMIA, vërehet se numri i fëmijëve me asnjë prind është 10 ose 0.07% e nxënësve, ndërsa me një prind është 328 ose 2.34% e nxënësve.

Nxënës me dy prind		Nxënës me një prind		Nxënës me asnjë prind		Gjithsej nxënës
Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
13685	97.59	328	2.34	10	0.07	14023

Gjendja sociale e nxënësve në vitin shkollor 2023/24

Nga numri i përgjithshëm i nxënësve të regjistruar për vitin shkollor 2023/24, në SMIA janë deklaruar 1224 nxënës me asistencë sociale, 8.73% e numrit të përgjithshëm të nxënësve.

Pasqyra e gjendja sociale të nxënësve				
Me asistencë sociale		Pa asistencë sociale		Gjithsej nxënës
Nr.	%	Nr.	%	
1224	8.73	9502	67.76	14023

Raporti i mungesave për kokë nxënësi sipas niveleve shkollore

Nga raporti i mungesave për vitin shkollor 2022/23 vërehet se numri më i madh i mungesave është në nivelin e mesëm të lartë, ku numri i mungesave për kokë nxënësi është 21.25 mungesa dhe atë 12.81 me arsye ndërsa 8.44 paarsye. Këto mungesa janë më të theksuara te shkollat profesionale.

Lloji i mungesave	Mungesat për kokë nxënësi			
	Klasa 1-5	Klasa 6-9	Klasa 10-12	Gjithsej
Të arsyeshme	7.96	15.91	12.81	11.83
Të paarsyeshme	0.83	3.53	8.44	3.82
Gjithsej	8.79	19.44	21.25	15.65

Braktisja e shkollës në tri vitet e fundit

Sipas të dhënave statistikore të deklaruara në SMIA, niveli i braktisjes së shkollimit në shkollat e mesme të larta ka tendencë të rritjes dhe atë kryesisht në shkolla profesionale siç është pasqyruar në tabelën e poshtëshënuar.

Viti shkollor	Lloji i shkollës	Mashkull		Femër		Gjithsej	
		Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
2020/21	Shkollë e Mesme e Lartë Profesionale	2	0.013	6	0.039	8	0.052
	Gjithsej	2	0.013	6	0.039	8	0.052
2021/22	Shkollë e Mesme e Lartë Profesionale	6	0.040	5	0.034	11	0.074
	Gjithsej	6	0.040	5	0.034	11	0.074
2022/23	Shkollë e Mesme e Ulët	1	0.007	0	0.000	1	0.007
	Shkollë e Mesme e Lartë Profesionale	18	0.126	7	0.049	26	0.182
	Gjithsej	19	0.133	7	0.049	27	0.189

Duke u mbështetur në të gjitha të dhënat e shënuara më lartë, e në veçanti të dhënat për numrin e nxënësve braktisës, numrin e nxënësve minoritar, numrin e mungesave, numrin e nxënësve të pa notuar, statusin social, distancën shkollë-shtëpi dhe numrin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, mund të përfundojmë se te profili i nxënësit braktisës në komunën tonë dominon nxënësi i shkollës së mesme të lartë profesionale dhe pas tij nxënësit minoritar (Rom, Ashkali dhe Egjiptas) të cilët nuk regjistrohen në shkollë, si dhe nxënësit me nevoja të veçanta arsimore të cilëve në nivelin e shkollimit 1-5 u ofrohet një mbështetje më e mirë, ndërsa në nivelin 6-9 zvogëlohet mbështetja dhe në nivelin e mesëm të lartë shumë pak nga këta nxënës e vazhdojnë shkollimin si rezultat i mungesës së mbështetjes profesionale.

Duke e pasur parasysh profilin e nxënësit braktisës, ky plan përmes objektivave që janë detajuar me aktivitete, indikatorë, afate kohore, institucione përgjegjëse dhe mbështetëse, si dhe me buxhetin e planifikuar, do të ndikoj në Parandalimin dhe Identifikimin e hershëm të nxënësve që janë në rrezik të braktisjes dhe do të ofroj ndërhyrje të duhura për t'i mbështetur ata, si këshillim, mbështetje dhe mentorim.

Qëllimi i planit të punës

Koordinimi i veprimeve ndërinstytucionale dhe ngritja e kapaciteteve në nivel lokal dhe shkollor në zbatim të detyrimeve ligjore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, duke rritur përfshirjen e fëmijëve në arsim dhe zvogëlimin e braktisjes.

Objektivat e Planit Komunal të Veprimit

- **Objektiva e përgjithshme I:** Parandalimi dhe Identifikimi i hershëm i nxënësve në rrezik të braktisjes dhe ofrimi i ndërhyrjeve të duhura për t'i mbështetur ata, si këshillim, mbështetje dhe mentorim

Objektivat specifike:

- 1.1 Funksionalizimi i EPRBM-ve komunale dhe shkollore, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i braktisjes në nivel komune;
- 1.2 Koordinimi ndërinstytucional dhe me partnerë zhvillimorë në mbështetjen e aktiviteteve të shkollave;
- 1.3 Monitorimi i progresi akademik dhe joakademik i nxënësve dhe t'u ofrohet atyre mbështetje kur është e nevojshme.

- **Objektiva e përgjithshme II:** Ulja e përqindjes së e braktisjes së shkollës duke krijuar një tranzicion të lehtë nga shkolla e mesme e ulët në shkollën e mesme të lartë, bazuar në mundësitë e karrierës që përputhen me aftësitë, dhe interesat e nxënësve

Objektivat specifike:

- 2.1. Lehtësimi i kalimit nga shkolla e mesme të ulët me shkollën e mesme të lartë duke filluar nga klasa e 6-të;
- 2.2. Ndërgjegjësimi i prindërve dhe nxënësve për orientimin në profile sipas kompetencave dhe interesave të fëmijës;
- 2.3. Krijimi i partneriteteve me bizneset lokale për të ofruar mundësi të punës praktike, programe të mentorimit dhe mundësi për krijimin e vendeve të punës
- 2.4. Monitorimi i zbatimit të planit të veprimit.

Këto objektiva janë detajuar me aktivitete, indikatorë, afate kohore, institucione përgjegjëse dhe mbështetëse, si dhe me buxhetin e planifikuar, ashtu që lehtësisht monitorohen në faza periodike.

Rezultatet kryesore të pretenduara:

- Rritja e monitorimit dhe mbikëqyrjes nga inspektorati
- Funksionalizimi i EPRMB në Komunë dhe në të gjitha shkollat
- Në fund të secilit vit pretendojmë rezultate konkrete për numrin / përqindjen e rasteve të zgjidhura
- Përgjigjja ndaj rasteve të nx. të panotuar dhe me shumë mungesa
- Rritja e raportimit cilësor nga shkollat/zvogëlimi i braktisjes

Buxheti:

Buxheti i paraparë në këtë plan arrin deri në **81,120.00 €**.

Monitorimi:

Zbatimin e këtij plani e monitori EPRBM komunale, e cila bën raport vjetor mbi zbatimin e planit. Ky plan veprimi do të shoqërohet me kornizë monitoruese, e cila do ta lehtësojë procesin e monitorimit dhe raportimin në afatet e përcaktuara, gjashtëmujore dhe vjetore.

Objektiva e përgjithshme 1. Fuqizimi i EPRBM-ve për parandalim dhe identifikim të hershëm të nxënësve në rrezik të braktisjes dhe ofrimi i ndërhyrjeve të duhura për t'i mbështetur ato, si këshillim, mbështetje dhe mentorim								
Objektiva specifike 1.1: Funkcionalizimi i EPRBM-ve komunale dhe shkollore, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i braktisjes në nivel komune								
Nr.	Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti
			2024	2025	2026			
1.1.1	Funksionalizimi i EPRBM-së komunale me takime dhe raportime të rregullta	Vendimi Procesverbalet Agjendat	x			DA	Komuna MASHTI	0.00€
1.1.2.	Rishikimi i funksionimit të EPRBM-ve në të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar	Vendimet e EPRBM-ve shkollore Plani i punës Procesverbalet Raportimet në SPH-SMIA	x			EPRBM komunale	Komuna DA Shkollat	0.00€
1.1.3	Seanca mbështetëse për EPRBM-në komunale	Agjendat Listat e pjesëmarrjes 5 seanca Plani i veprimit	x	x		DA	Komuna MASHTI Partnerët	450.00€

1.1.4	Seanca mbështetëse për EPRBM-të shkollore	Agjendat Listat e pjesëmarrjes 11 seanca/160 përfaqësues	x	x		DA	Komuna MASHTI Partnerët	2,400.00€
1.1.5.	Asistimi i EPRBM-ve shkollore për përdorimin e SPH-së	11 takime 32 shkolla	x	x	x	DA	Komuna MASHTI Partnerët	770.00€
1.1.6.	Shkëmbimi i përvojave të EPRBM-ve shkollore	2 takime 32 pjesëmarrës	x	x	x	DA EPRBM komunale	DA Partnerët	1,800.00€
Objektiva specifike 1.2: Koordinimi ndërinstitutional dhe me partnerë zhvillimor në mbështetjen e aktiviteteve të shkollave dhe nxënësve në nevojë								
	Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti
			2023	2024	2025			
1.2.1	Takime koordinuese me partnerë	5 takime/vit Marrëveshjet e bashkëpunimit	x	x	x	DA	Komuna MASHTI Partnerët	0.00€

1.2.2	Zhvillimi i projekteve ndërsektoriale në parandalim të dukurive negative që e sfidojnë vijimin e rregullt të shkollës të gupeve të caktuara të nxënësve	3 aktivitete ndërgjegjësuere/vit 32 shkolla përfituese		x	x	DA	Drejtoritë tjera komunale (DSh, DMS, Zyra për komunitete dhe kthim, Policia në bashkësi) Partnerët	600.00€
1.2.3	Mbështetja e nxënësve të ShMLT “Arkitekt Sinani” me bursa për motivimin e shkollimit të qëndrueshëm sipas rregullores komunale 10/2023	50 bursa/vit 50 nxënësve përfitues/vit	x	x	x	DA ShMLT “Arkitekt Sinani”	Komuna Kuvendi Komunal	37,000.00€
1.2.3.	Ligjërata në shkolla nga pedagogët/psikologët e shkollave për dukurinë e braktisjes	4 ligjërata në shkolla të mesme të larta profesionale/vit	x	x	x	Pedagogët/Psikologët e shkollave	DA Shkollat	0.00€
1.2.4.	Fushata sensibilizuese për regjistrimin e nxënësve të	Broshura Postera	x	x	x	DA Shkollat	Komuna DA	3,500.00€

	komuniteteve në lagjen “Adem Voca”	Kampanja sensibilizuese				Komiteti për komunitete Zyra për komunitete	Partnerët Donatorët	
1.2.5.	Aktivitetet ndërgjegjëse për punën e lejuar të nxënësve në shkollat e mesme të larta pa e penguar procesin mësimor	Lista e nxënësve që punojnë	x	x	x	MASHTI DA	MASHTI DA	1,500.00€
Objektiva specifike 1.3: Monitorimi i progresit akademik dhe joakademik i nxënësve dhe t'u ofrohet atyre mbështetje kur është e nevojshme.								
	Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti
			2023	2024	2025			
1.3.1.	Takimet e rregullta me prindërit, mësuesit dhe administratorët e shkollave për të rishikuar përparimin akademik dhe joakademik të nxënësve	Takimet e realizuara	x	x	x	Shkollat	DA	900.00€
1.3.2.	Sigurimi i fondeve për aktivitetet mbështetëse për nxënësit që kanë vështirësi akademike ose personale;	Buxheti i ndarë Aktivitetet e realizuara	x	x	x	DA Shkollat	MASHTI MEF	1,500.00€

1.3.3	Zbatimi i sistemit kombëtar për identifikimin dhe adresimin e faktorëve të rrezikut për braktisjen e shkollës, si mungesat në shkollë, performancë e dobët akademike dhe çështjet e sjelljes.	SPH funksional dhe i përdorshëm nga të gjitha shkollat	x	x	x	Shkollat DA	MAShTI Partnerët	700.00€
Objektiva e përgjithshme 2. Ulja e përqindjes së e braktisjes së shkollës duke krijuar një tranzicion të lehtë nga shkolla e mesme e ulët në shkollën e mesme të lartë, bazuar në mundësitë e karrierës që përputhen me aftësitë, dhe interesat e nxënësve.								
Objektiva specifike 2.1: Lehtësimi i kalimit nga shkolla e mesme e ulët në shkollën e mesme të lartë duke filluar nga klasa e 6-të								
Nr.	Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti
			2024	2025	2026			
2.1.1	Zbatimi i politikave për orientimin në karrierë në fazat e hershme dhe me fokus për nxënësit e klasës së 6-të.	U.A i zbatueshëm Aktivitet e rregullta, të realizuara	x	x	x	Shkollat DA	MAShTI Partnerët	0.00€

2.1.2.	Organizimi i panairove të karrierës për t'i ekspozuar nxënësve para profesioneve të ndryshme dhe mundësi punësimi.	Panairot e shkollave profesionale	x	x	x	Shkollat DA	Komuna DA Partnerët	10,000.00€
2.1.3	Hartimi i një programi që i ndihmon nxënësit në planifikimin e karrierës dhe vendimmarrjen, i cili përfshin lidhjen e tyre me shkollat e mesme të larta.	Programi i hartuar dhe i shpërndarë në shkolla		x	x	Shkollat DA Qendra e Karrierës në ShMLT “Arkitekt Sinani”	MAShTI Partnerët	500.00€
2.1.4	Organizimi i vizitave të nxënësve të klasave 6-7 dhe 8-9 në shkollat e mesme të larta	Pjesëmarrja e nxënësve	x	x	x	DA ShFMU	DA Shkollat e mesme të larta	8,500.00€
2.1.5.	Organizimi i vizitave të nxënësve të klasave të nënta në biznese	Pjesëmarrja e nxënësve	x	x	x	DA	DA ShFMU	3,500.00€

Objektiva specifike 2.2: Ndërgjegjësimi i prindërve dhe nxënësve për orientimin në profile sipas kompetencave dhe interesave të fëmijës								
	Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti
			2024	2025	2026			
2.2.1	Përgatitja e materialeve informuese për prindër dhe nxënës.	Materialet e përgatitura	x	x	x	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	1,500.00€
2.2.2	Punëtori me prindër për promovimin e profileve arsimore dhe përparësitë e orientimit të saktë të fëmijëve në shkollimin e mesëm	Nr. i punëtorive, takimeve të realizuara	x	x	x	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	3,000.00€
2.2.3	Seminare për nxënësit e shkollave të mesme të ulëta për të eksploruar aftësitë, interesat dhe aftësitë e tyre.	Nr. i seminareve të realizuara me nxënës	x	x	x	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	1,500.00€
2.2.3.	Takime të përbashkëta me prindër, nxënës me folës motivues.	Numri i takimeve të realizuara	x	x	x	Shkollat DA	MAShTI Partnerët	600.00€

2.2.4	Hulumtim për numrin e nxënësve të regjistruar nga klasa e 9-të në klasën e 10-të	Evidenca e nxënësve të regjistruar	x	x	x	Shkollat DA	Shkollat	0.00€
Objektiva specifike 2.3. Krijimi i partneriteteve me bizneset lokale për të ofruar mundësi të punës praktike, programe të mentorimit dhe mundësi për krijimin e vendeve të punës.								
	Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti
			2024	2025	2026			
2.3.1.	Identifikimi i bizneseve dhe krijimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit	Nr. i marrëveshjeve dhe i partnerëve	x	x	x	Shkollat DA	MAShTI Partnerët	0.00€
2.3.2.	Zbatimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit sipas përgjegjësisve të ndara	Nr. i shkollave dhe profileve përfituese të marrëveshjeve Nr. i nxënësve që mbështeten për punën praktike.	x	x	x	Shkollat DA	MAShTI Partnerët	0.00€

Objektiva specifike 2.4. Monitorimi i zbatimit të planit të veprimit								
	Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti
			2024	2025	2026			
2.4.1.	Zhvillimi dhe aprovimi i kornizës monitoruese	Korniza monitorues e zhvilluar	x			DA Shkollat	MAShTI Partnerët	600.00€
2.4.2.	Mbledhja e të dhënave sipas kornizës monitoruse	Të dhënat e mbledhura	x	x	X	DA Shkollat	MAShTI Partnerët	0.00€
2.4.3	Analiza e të dhënave	Të dhënat e analizuara	x	x	X	DA Shkollat	MAShTI Partnerët	300.00€
2.4.4.	Raportimi mbi zbatimin e planit të veprimit	Raportimi i rregullt vjetor	x	x	X	DA Shkollat	MAShTI Partnerët	0.00€

Shtojca: Korniza përkatëse ligjore, dokumentet e politikave dhe referencat shtesë

Ligjet

- Kushtetuta e Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>
- Ligji 04/L-032 për Arsimin parauniversitar në Kosovë, 16 shtator 2011, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770>
- Ligji nr. 2003/12 për Qasjen në dokumente zyrtare, 6 nëntor 2003, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2470>
- Ligji nr. 03/L – 172 për Mbrojtjen e të dhënave personale, 31 Maj 2010, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2676>
- Ligji nr. 02/L-37 për Përdorimin e gjuhëve, 1 Mars 2007 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2440>

Udhëzimet administrative

- Udhëzimi administrativ 08/2018 për themelimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin parauniversitar <https://masht.rks-gov.net/udhezimi-administrativ-masht-nr-08-2018-per-themelimin-dhe-fuqizimin-e-ekipeve-parandalimdhe-kbmnapu/>
- Udhëzimi administrativ nr. 9/2011 për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave statistikore nga shkollat dhe institucionet parashkollore në arsimin parauniversitar duke përdorur sistemin për menaxhimin e informatave në arsim, 30 dhjetor 2012, <https://masht.rks-gov.net/9-ua-per-mbledhjen-dhe-raportimin-e-te-dhenave-statestikore-nga-shkollat-dhe-institucionet-parashkollore-ne-arsimimin-parauniversitar-duke-perdorur-sistemin-per-menaxhimin-e-informative-ne/>
- U.A për transferin e nxënësve <https://masht.rks-gov.net/16-ua-per-kalimin-e-nxenesit-te-shkolles-se-mesme-te-larte-prej-nje-profil-arsimor-ne-tjetrin-prej-nje-shkolle-ne-shkollen-tjeter-nr-16-2011-date-30-12-2011/>
- UA. 08/2022 për dokumentacionin shkollor të arsimit parauniversitar, <https://masht.rks-gov.net/udhezim-administrativ-masht-nr-08-per-dokumentacionin-shkollor-ne-arsimin-parauniversitar>

- U.A 03/2012 Barasvlera dhe njohja e dokumenteve të arsimit parauniversitar të lëshuara jashtë Republikës së Kosovës <https://masht.rks-gov.net/ua-barasvlera-dhe-njohja-e-dokumente-te-arsimit-parauniversitar-te-leshuara-jashte-republikes-se-kosoves-nr-03-2012-date-02-05-2012/>
- U.A. 19/2015, Për sistemimin e nxënësve të cilët kanë migruar nga viti shkollor 2014/2015 <https://masht.rks-gov.net/ua-masht-nr-19-2015-per-sistemin-e-nxenesve-te-cilet-kane-migruar-nga-viti-shkollor-2014-2015/>
- U.A. 1/2016, Përcaktimi i kushteve, kriterëve dhe procedurave për organizimin e mësimi plotësues për nxënësit e riatdhesuar <https://masht.rks-gov.net/ua-nr-01-2016-dt-12-01-2016-per-percaktimin-e-kushteve-kriterëve-dhe-procedurave-per-organizimin-e-mesimit-plotesues-per-nxenesit-e-riatdhesuar-organizimi-dhe-planifikimi-i-procesit-arsimor-ne-ars/>
- U.A 01/2014 për organizimin dhe planifikimin e AAP <https://masht.rks-gov.net/ua-masht-nr-01-2014-organizimi-dhe-planifikimi-i-procesit-arsimor-ne-arsimin-dhe-aftesimin-profesional/>.
- U.A 02/2014 Numri i nxënësve me module dhe kualifikime të AAP, resurset, infrastrukturadhe siguria e nxënësve <https://masht.rks-gov.net/ua-masht-nr-02-2014-numri-i-nxenesve-me-module-dhe-kualifikime-te-aap-resurset-infrastruktura-shkollore-siguria-e-nxenesve/>
- UA (MASHT) Nr. 06.2014 Kodi i mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënës të shkollave të mesme të larta <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10128>
- UA- MASHT Nr: 12/2014 Përfshirjet në moshë me rastin e regjistrimit në arsimin dhe aftësimin për të rritur <https://masht.rks-gov.net/ua-masht-nr-12-2014-perjashtimet-ne-moshe-me-rastin-e-regjistrimit-ne-arsimin-dhe-aftesimin-per-te-rritur/>

(Politika për mësimin dual ka filluar nga shtatori 2022 fillimisht në 4 profile: kuzhinier, asistent i restorantit, floktar dhe murator)

Ministria e Arsimit është e interesuar për sistemin dual të mësimi, me synimin që në secilën komunë të bashkëpunohet me bizneset që kanë mundësi punësimi për të rinjtë, duke u kujdesur për sigurinë në punë dhe çështjet që ndërlidhen me punën që e bëjnë nxënësit nën moshën 18 vjet.

Strategjitë kombëtare/planet e veprimt

- Plani strategjik i arsimit në Kosovë (2022-2026),
- Strategjia për të drejtat e fëmijës (2019-2023),
- Strategjia kombëtare kundër trafikimit me njerëz në Kosovë (2022-2026),
- Strategjia dhe plani i veprimt për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë kosovare (2022-2026).

Të tjera

- *Mundësi të Barabarta për arsim për të gjithë, Doracak për ekipet shkollore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar* (MASHT, 2023)
- *Mundësi të Barabarta për arsim për të gjithë, Doracak për ekipet komunale për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar* (MASHT, 2023)
- Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), *Trajtimi i refuzimit të shkollës dhe braktisjeve: doracak i orientuar kah praktika* [Dealing with school refusal and dropouts: A practice-oriented manual] (tetor 2011).
- Raporti i OSBE-së: *Përcjellja e braktisjes së shkollës dhe mosvijimit në Kosovë* <http://ëëë.osce.org/sq/kosovo/95113?download=true> (qasur më 24 mars 2014).
- *Regjistrimi dhe braktisja e shkollës nga vajzat në Kosovë* (MASHT & UNICEF2004).
- *Braktisja e shkollës nga nxënësit në Kosovë* (MASHT, 2008)
- Instituti Pedagogjik i Kosovës, *Fëmijët jashtë shkollës – Studim bazë për praktikën e parandalimit dhe të reagimit ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë* (2014)
- UNICEF, *Përmbledhje e Politikave - Të gjithë fëmijët regjistrohen, vijojnë dhe përfundojnë arsimimin*, 2014